

LEKSION I HAPUR NGA PROFESORI DR. ANGELOS MICHALAS, PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT TË INXHINIERI INFORMATIKËS NË INSTITUTIN TEKNOLOGJIK TË MAQEDONISË PERËNDIMORE, KASTORIA, GREQI.

Ditën e martë në datë **24 Tetor 2017**, në auditorin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane u zhvillua një leksion i hapur nga profesori **Dr. Angelos Michalas**, Përgjegjësi i Departamentit të **Inxhinieri Informatikës në Institutin Teknologjik të Maqedonisë Perëndimore, Kastoria, Greqi**.

Në kuadër të bashkëpunimit të universiteteve me njëri-tjetrin; ky leksion kishte për qëllim të realizonte një shkëmbim eksperiencash dhe kontributesh në fushën e sistemeve të telekomunikacionit dhe teknologjive të reja. Profesori Michalas, prezantoi njëkohësisht edhe një nga programet Master të Shkencave, pranë institutit që ai përfaqëson, i cili ofron dije në fushën e *“Sistemeve të Telekomunikacionit, Teknologjive të reja në Internet dhe Sistemeve të Sigurisë”*. Ky program studimi ishte një risi e institutit të tyre dhe ndërthurte modulet dhe praktikatat më kontemporane në ndihmë të nevojave të tregut.

Në prezantim morrën pjesë studentë nga programet *Teknologji Informacioni dhe Matematikë Informatikë*, stafi i departamentit Matematikë-Fizikë-Informatikë, Dekani i fakultetit Prof. dr. Gjergji Pendavinji si dhe të ftuar të tjerë.

